

PROF. ASOC. DR. HASAN BELLO

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë
hasanbello1@gmail.com

**POLITIKA EKSPANSIONISTE E ITALISË NDAJ
TERRITOREVE SHQIPTARE NGA FUNDI I SHEK. XIX DERI
NË FILLIM TË SHEK. XX****Abstrakt:**

Ky artikull analizon politikat ekspansioniste të Italisë ndaj territoreve shqiptare nga fundi i shek. XIX deri në fillim të shek. XX, duke u përqendruar tek interesat strategjike italianë në Adriatik dhe Ballkan. Përmes shqyrtimit të burimeve historike italiane dhe shqiptare trajtohen përpjekjet diplomatike, kulturore dhe ushtarake për të siguruar ndikim mbi Shqipërinë, duke përfshirë mbështetjen e institucioneve arsimore, klerin katolik, komitetet “pro Albania”, si edhe konkurrencën me Austro-Hungarinë. Studimi thekson rolin e rivalitetit austro-italian në formësimin e kësaj strategjie. Ky rivalitet u shfaq veçanërisht në fushën fetare dhe arsimore, duke u pasqyruar në numrin e madh të shkollave që qeveria italiane financoi në këtë periudhë në qytetet shqiptare, si edhe në funksionimin e zyrave postare e konsullore, si dhe në marrëdhëniet tregtare.

Fjalë kyç:

Shqipëri, Itali, Austro-Hungari, politika ekspansioniste italiane, arsim.

Në politikën e jashtme të Italisë, Shqipëria dhe Tripoli konsideroheshin si dy pika nevralgjike që i mundësonin asaj kontrollin e Adriatikut dhe ekspansionin drejt territoreve të reja.¹ Duke filluar nga çereku i fundit të shek. XIX, vilajetet shqiptare nënkuptonin zonën e saj të influencës politike, ekonomike dhe kulturore. Prandaj, vendosja e një

¹ Rolando Neri, *Sonnino, Guicciardini e la politica estera italiana 1899-1906* (Roma: Edizioni ETS, 2005), 42-43.

fuqie tjetër në këto hapësira² – siç ishte rritja e ndikimit austro-hungarez – perceptohej nga Roma si një kërcënim serioz për Romën.³ Fillimisht, italianët nuk treguan një interes të madh për Shqipërinë edhe pse Kryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme, Francesco Crispi,⁴ kërkoi gjatë viteve 1887-1888 që zëri i Italisë të dëgjohej përtej Alpeve dhe që ajo të mos qëndronte e huaj në Gadishullin Ballkanik.⁵

Rikonfirmimi i pjesëmarrjes së Italisë në Aleancën Trepalëshe më 20 shkurt 1887 përcaktoi të drejtën e saj që, së bashku me Austro-Hungarinë dhe me qëllim ruajtjen e *status quo*-së territoriale në Lindje, të angazhohej për të përdorur influencën e vet për të penguar çdo ndryshim territorial që cenonte interesat e të dyja palëve. Ato do të komunikonin me njëra-tjetrën për të sqaruar çdo qëndrim ndaj këtyre territoreve.⁶ Nëse ruajtja e *status quo*-së në Ballkan, si edhe në brigjet dhe ishujt osmanë të Adriatikut e Egjeut do të ishte e pamundur, Austro-Hungaria dhe Italia do të pushtonin përkohësisht apo në mënyrë të qëndrueshme këto territore. Kjo do të realizohej në marrëveshje me njëra-tjetrën, duke zbatuar parimin e kompensimit reciprok territorial dhe duke kënaqur interesat e tyre.⁷ Njëkohësisht, kjo marrëveshje e detyronte Austro-Hungarinë të ndante influencën e saj në Ballkan me Italinë.

Megjithatë, me iniciativën e Krispit, duke nisur nga korriku i vitit 1888, Italia nisi një fushatë rivaliteti me Austro-Hungarinë, e cila gjeti shprehje në hapjen e një numri të madh konsullatash dhe shkollash përgjatë brigjeve të Mesdheut. Me motivacionin e arsimimit të qytetarëve të vet dhe, natyrisht, për çështje influence, qeveria italiane hapi shkolla shtetërore në Shkodër, Vlorë, Prevezë dhe Janinë.⁸ Në këtë veprim,

² Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 98, Viti (më tej: V.) 1878, Dosja (më tej: D.) 1, fl. 1. Protestë e Komitetit Shqiptar në Itali kundër pretendimeve greke për aneksimin e Shqipërisë së Jugut, 12 shkurt 1878.

³ Giovanni Amadori Virgilio, *La questione Rumeliota (Macedonia, Vecchia Serbia, Albania, Epiro) e la politica italiana*, Volume primo (Bitonto: N. Garofalo, 1908), 3.

⁴ Për veprimtarinë politike dhe kontributin e tij, shih: *Crispi per un antico parlamentare col suo diario della spedizione dei mille* (Roma: Edoardo Perino Editore-Tipografo, 1890).

⁵ Pio Bondioli, *Albania quinta sponda D'Italia* (Milano: C.E.T.I.M, 1939), 77.

⁶ Alberto Rovere, *Italia ed Austria nella questione d'Oriente* (Palermo: 1887), 1-27.

⁷ Claude Alexandre Cailler, *La politique balkanique de l'Italie entre 1875 et 1914* (La Tour-de-Peilz: Imprimerie Stalder-Vodroz, 1951), 105.

⁸ Antonio Baldaci, *Studi speciali albanesi*, Vol. 1 (Roma: Anonima Romana Editoriale, 1932), 173.

Austro-Hungaria pa qëllimin e Italisë për të goditur influencën e saj. Çështja e shkollave ndezi konfliktin austro-italian dhe bëri që Vjena të ndërmernte masa për t'i zhdukur këto “vatra infeksioni”.⁹

Në përpjekjet e saj për depërtimin në Ballkan në lëmin arsimor, qeveria italiane kërkonte gjithnjë përkrahjen e Vatikanit. Kryeministri italian, Krispi, që më 1888, i këshilluar nga ambasadori i Italisë në Stamboll, Blank, i propozoi Vatikanit që Italia të dërgonte një delegacion në Stamboll për të mbrojtur interesat e kishës katolike.¹⁰ Kuptohet se, sipas Krispit, këtë të drejtë nuk duhej ta kishte më Austro-Hungaria, por Italia, e cila do të ndërhynte më energjikisht. Megjithatë, për arsye të njohura, Vatikani mbeti i lidhur me Vjenën.¹¹ Me rënien e qeverisë së Krispit dhe për shkak të vështirësive financiare, zgjerimi i influencës dhe i shkollave italiane në vilajetet shqiptare pësoi një frenim të përkohshëm.¹²

Marrëdhëniet jo të mira midis Italisë dhe Vatikanit në këtë periudhë u shfrytëzuan nga Austro-Hungaria, e cila, duke pasur parasysh se shumica e shkollave italiane ishin laike, nxiti klerin katolik, me në krye argjipeshkvin e Shkodrës, Paskuale Guerinin, që në vitin 1896 të lëshonte një mallkim ndaj të gjitha familjeve shkodrane që dërgonin fëmijët e tyre në shkollat italiane. Kjo gjendje vazhdoi gati tre vjet (1896-1898), derisa kleri, ndoshta me urdhër të Vatikanit, hoqi dorë nga ky qëndrim.¹³

Në fund të shek. XIX, Italia, krahas konsullatave, zyrave postare, shoqërive të lundrimit dhe aktivitetit tregtar, me qëllim që të ruante me anë të mësimit të gjuhës dhe kulturës amtare italianitetin në vendet irredentiste dhe te bashkëqytetarët e shpërndarë nëpër botë si emigrantë, themeloi shoqërinë “Dante Alighieri”.¹⁴ Kjo shoqëri shërbeu si mjet për

⁹ *Po aty*, 293.

¹⁰ Nicolo Inglese, *Crispi* (Milano: Dall'Oglio, 1961), 36; U. Nani, “I rapporti con l'Albania da Francesco Crispi ad oggi”, *La Terra*, nr. 6 (aprile 1939), 183-190.

¹¹ Mikel Prenushi, “Vështrim historik mbi zhvillimin e arsimit në Shkodrën e shek. XIX”, *Studime historike*, nr. 3 (1974): 73.

¹² Donato Sanminiatielli, *I rapporti tra l'Italia e l'Albania* (Firenze: Ufficio della Rassegna nazionale, 1901), 25; Antonio Baldacci, *Studi speciali albanesi*, Vol. II (Roma: Anonima Romana Editoriale, 1933), 155.

¹³ Beqir Sinani, “Politika arsimore e Italisë imperialiste ndaj Shqipërisë (1888-1920)”, *Studime historike*, nr. 4 (1970): 81.

¹⁴ Charles Loiseau, *L'équilibre adriatique (l'Italie et la question d'Orient)* (Paris: Perrin et Cie, 1901), 117-120.

të shtrirë hegjemoninë e saj edhe në territoret shqiptare.¹⁵ Në kongresin e saj të 12-të, konti Donato Sanminiatieli mbajti një referat me titull “Marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Italisë”, ku i propozoi qeverisë mbretërore italiane që të hapte zyra konsullore, një shkollë zejesh në Shkodër dhe të rihapeshin shkollat në Durrës, Vlorë e Prevezë. Shoqëria donte, për të popullarizuar politikën qeveritare dhe për të zgjuar interesin e rretheve shqiptare, të krijonte një bibliotekë italo-shqiptare me botime mbi Shqipërinë, me përkthime tekstesh shkollore në shqip etj. Në këtë referat, autori parashtrroi në formë kërkesë edhe shërbimet që mund t'i ofronin Italisë arbëreshët dhe kolegji i Shën Adrianit në Shën Miter Koronë.¹⁶ Në kuadër të kësaj politike, u rihap katedra e gjuhës shqipe në kolegjin e Shën Adrianit më 1889 dhe ajo e Institutit Oriental të Napolit më 1900; gjithashtu, arbëreshët organizuan dy kongrese gjuhësore, një më 1895 dhe tjetri më 1897.

Por të gjitha këto përpjekje të qeverisë italiane për të shtrirë ekspansionin dhe ndikimin e saj përtej Adriatikut ishin të vonuara. Austro-Hungaria, prej vitesh, kishte krijuar në Shqipëri privilegje dhe baza të qëndrueshme ekonomiko-kulturore për politikën e saj. Ajo kishte siguruar protektoratin fetar mbi kishën katolike, një fuqi e madhe, e organizuar dhe e vendosur krejtësisht në shërbim të saj. Me kohë, për të forcuar pushtetin ekleziastik dhe për të zgjeruar ndikimin e vet, Vjena kishte ndihmuar klerin katolik me subvencione e garanci politike në çeljen e shkollave konfesionale, të cilat zyrtarisht njiheshin si austriake. Përveç kësaj, ajo përdorte edhe mjete të tjera, si spitale, jetimore etj., si dhe një aparat të madh depërtimi, të drejtuar nga përfaqësues konsullorë të vendosur në pikat më të rëndësishme përgjatë bregdetit dhe brenda territorit shqiptar.

Megjithatë, ndikimi italian në hapësirën shqiptare avancoi me hapa të shpejtë dhe u favorizua edhe nga politika e qeverisë osmane. Më 1888, kjo qeveri, në vazhdim të politikës së saj kapitulluese ndaj Fuqive të Mëdha, për të nxitur e ashpërsuar kontradiktat italo-austriake në Ballkan, si dhe për të thelluar politikën e përçarjes së shqiptarëve të besimeve të

¹⁵ Kjo shoqëri u themelua në vitin 1889 dhe për disa dekada luajti një rol të rëndësishëm në ekspansionin italian në fushën e kulturës. Alfonso Manaresi, *Storia Contemporanea* (Milano: Casa Editrice Trevisini, 1931), 326.

¹⁶ Sanminiatielli, *I rapporti*, 25.

ndryshme, lejoi hapjen e shkollave italiane në Shkodër, Durrës, Vlorë dhe Prevezë.¹⁷

Shkollat italiane, të cilat u ofronin nxënësve më shumë njohuri praktike se shkollat e tjera, ngjallën interesin e borgjezisë së re shkodrane. Kjo e fundit preferoi t'i dërgonte fëmijët e saj në këto institucione, me qëllim që të përgatiste kuadro për nevojat e veta. Duke i vlerësuar zhvillimet në mënyrë pragmatike, ajo e konsideroi mësimin e gjuhës italiane si një mjet të dobishëm për t'u lidhur me botën tregtare të Mesdheut.¹⁸

Në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, çështja shqiptare u kthye në antagonizmin kryesor të raporteve austro-italiane, të cilat synonin kontrollin e Adriatikut.¹⁹ Italia e shihte me shqetësim zgjerimin e influencës austriake në Shqipëri. Me "kapjen" e Vlorës, kontrollohej edhe kanali i Otrantos, duke e kthyer Adriatikon në një det austriak. Prandaj, autoritetet italiane mendonin se Roma nuk duhej të kufizohej vetëm në një funksion pasiv vigjilence; ajo duhej të kontrollonte dhe njëkohësisht të minonte influencën austriake në ato zona që konsideroheshin me rëndësi jetike.²⁰ Në radhë të parë, bëhej fjalë për Shqipërinë e Jugut, veçanërisht për Vlorën dhe hinterlandin e saj, që konsiderohej si një vend tranziti dhe depërtimi drejt territoreve të brendshme.²¹ Megjithatë, politikanët italianë ishin të ndërgjegjshëm për inferioritetin e tyre krahasuar me konsujt, misionarët, agjentët politikë apo tregtarë austro-hungarezë në Shqipëri.²² Për këtë arsye, afrimi austro-rus në këtë periudhë shihej me xhelozë nga ana e italianëve. Austro-Hungaria, e bashkuar me Rusinë, mund të shtypte njëherë e përgjithmonë Perandorinë Osmane në Europë, duke u bërë kështu padrone në bregun tjetër të Adriatikut, ku interesat e Italisë ishin vënë në pikëpyetje.²³ Sipas studiuesve italianë, përderisa Perandoria Austro-Hungareze ishte e pranishme në Adriatik, Italia mbetej në një pozitë

¹⁷ Prenushi, "Vështrim historik", 71-72.

¹⁸ Po aty, 72.

¹⁹ C. A. Ferrario, *Vicende e problemi della penisola balcanica 1815-1937* (Milano: Istituto per gli studi di politica internazionale, 1937), 98.

²⁰ Amedeo Giannini, *La formazione dell'Albania* (Roma: Anonima. Romana Editoriale, 1929), 19.

²¹ Eugenio Barbarich, *Albania* (Roma: Editore Enrico Voghera, 1905), XVIII.

²² Bondioli, *Albania quinta sponda*, 14.

²³ Isidoro Reggio, *Storia della Grande Guerra* (Milano: Istituto Editoriale Italiano, 1916-1919), 47.

inferioriteti, pa asnjë lloj zgjidhjeje. Politikisht, ajo përballej me pengesën më të madhe në rrugën e depërtimit të influencës së saj në Ballkan, në Dalmacinë austriake dhe të sllavizuar. Prandaj, Italia ishte e detyruar të hidhte vështrimin drejt Shqipërisë, por edhe aty përballej me interesat e Austro-Hungarisë dhe rrezikonte të hynte në konflikt me të.²⁴ Përrjashtimi i Austro-Hungarisë nga Adriatiku do ta privonte atë si fuqi detare dhe do ta kthente në një fuqi të dorës së dytë.²⁵ Në politikën e saj “adriatikase”, Vjena pretendonte të ishte trashëgimtare e Venecies dhe, duke u nisur nga ky qëndrim, zyrtarët e saj synonin t’i siguronin Monarkisë Danubiane të drejtën e panegociueshme për predominim në Adriatik dhe në Shqipëri.²⁶ Territorët shqiptarë, të vendosura në kryqëzimin e rrugëve, përfytyroheshin si një kushinetë në zemër të portës së Adriatikut, duke u kthyer në arenë ku përplaseshin interesat e të dyja palëve.²⁷

Austro-Hungaria dhe zyrat e saj konsullore në qytetet shqiptare shihnin me shqetësim veprimtarinë e institucioneve arsimore italiane. Më 1 janar 1889 në qytetin e Shkodrës u hapën shkolla italiane për djem dhe për vajza, si dhe një azil për fëmijët parashkollorë.²⁸

Shkollat italiane, të hapura në qytetet bregdetare të Shqipërisë dhe nëpër fshatrat më të mëdha, mblidhnin shumë fëmijë shqiptarë, të cilët mësonin gjuhën dhe historinë italiane. Megjithatë, midis tyre dhe popullit italian do të qëndronte gjithmonë kisha katolike, për sa kohë Vatikani dhe Kuirinale vazhdonin të ishin në konflikt me njëri-tjetrin.²⁹

Në Shkodër ekzistonin shkolla shtetërore italiane, të cilat konkurren me sukses shkollat e subvencionuara nga regjimi monarko-perandorak, pasi nuk kërkonin pagesë; ndërkohë, shkollat e urdhrit fetar françeskan dhe jezuit kërkonin para nga prindërit, të cilët në pjesën më të madhe ishin të varfër.³⁰

²⁴ Attilio Tamaro, *L'Adriatico golfo d'Italia: L'italianita di Trieste* (Milano: Fratelli Treves-Editori, 1915), 117.

²⁵ Loiseau, *L'équilibre adriatique*, 125-126.

²⁶ Autor i panjohur, *Adriatico, Studio geografico, storico e politico* (Milano: Treves, 1915), 24.

²⁷ *Po aty*, f. 25.

²⁸ Vico Montegazza, *L'Albania* (Milano: Bontempelli & Invernizzi, 1912), 126.

²⁹ N. Marenin, *Shqipëria dhe shqiptarët* (Tiranë: ENEAS, 2012), 100-101.

³⁰ Annelise Wernicke, *Teodor Ipen dhe Shqipëria në fokusin e Perandorisë Austrohungareze* (Tiranë: Plejad, 2012), 63.

Më 10 nëntor 1898, konsulli austro-hungarez Ippen njoftoi Vjenën për pesë shkolla fillore klasike të mbajtura nga Ministria e Jashtme e Italisë në Shkodër, të cilat ishin shndërruar në qendra të një aktiviteti propagandistik, kryesisht të zhvilluar nga mësuesit jashtë shkollës.³¹ Gjithashtu, Ippen-i ankohej edhe për faktin se konsullatat italiane në Shqipëri u lejonin gazetave italo-shqiptare të zhvillonin një aktivitet nxitës të padëgjuar kundër Austro-Hungarisë, aktivitet që në fakt kryhej nga nëpunës të varur dhe nga mësuesit e shkollave. Ai kritikonte gjithashtu strategjinë dhe qasjen e politikës austro-hungareze ndaj shqiptarëve. Sipas tij, gjithçka që ndërmerrej nga pala italiane në Shqipëri i drejtohej drejtpërdrejt popullit, ndërsa Austro-Hungaria i përçonte veprat e saj të mira kryesisht nëpërmjet kanaleve të klerit katolik. Si pasojë, pjesa më e madhe e këtyre përpjekjeve absorbohej nga këto kanale, dhe vetëm një pjesë e vogël arrinte t'u shërbente interesave të popullit; megjithatë, edhe kjo pjesë nuk ishte plotësisht e kulluar. Një kritikë tjetër që ai i bënte politikës austro-hungareze lidhej me përqendrimin e saj vetëm në qytetin e Shkodrës, duke injoruar tërësisht rrethet e Elbasanit, Dibrës dhe Korçës. Ippen-i i propozoi qeverisë austriake, e cila nuk kishte asnjë informacion mbi ngjarjet, rrethanat dhe atmosferën në këto rrethe, ndërtimin e një përfaqësie konsullore austro-hungareze në sanxhakun e Elbasanit.³² Në këtë mënyrë, ai mendonte se mund të goditej deri në njëfarë mase influenza italiane.

Kongresi ndërkombëtar i orientalistëve, i cili i zhvilloi punimet në Romë në vitin 1899, shfaqti një orientim të qartë të politikës italiane në Shqipëri. Me mbështetjen e qeverisë italiane u ngritën shkolla, të cilat gëzonin pjesërisht edhe mbështetjen e klerit katolik italian. Organizatat tregtare zunë rrënjë në Shqipëri, shtypi shqiptar u subvencionua dhe u shtuan ndjeshëm udhëtimet e shkencëtarëve italianë. Atë që nuk mundi ta arrinte propaganda intensive kulturore dhe ekonomike, e realizoi një sistem i menduar mirë diplomatikisht, por edhe me mjete të tjera, përfshirë korrupsionin.

Kuptohet që Austro-Hungaria e shihte me pakënaqësi agjitacionin impulsiv italian, sepse pozicioni i deriatëhershëm i Monarkisë në Shqipëri i siguronte asaj rrugën e lirë për kalimin drejt Mesdheut.³³ Kleri

³¹ *Po aty*, 83-84.

³² *Po aty*, 84.

³³ *Po aty*, 80.

austriak filloi një fushatë të gjerë për të bojkotuar regjistrimet e nxënësve shqiptarë në shkollat italiane. Madje, qeveria austro-hungareze i forcoi zyrat e saj konsullore në Shqipëri me personel të ri.³⁴ Pavarësisht kësaj, qeveritarët italianë ishin të kujdesshëm që veprimet e arbëreshëve të mos e vinin Romën në një pozitë të vështirë diplomatike. Kjo u vu re në të tria kongreset shqiptare (1895, 1897, 1901)³⁵ dhe në shoqëritë që u krijuan në këtë periudhë.³⁶

Një nga protagonistët kryesorë të këtyre viteve, Anselmo Lorecchio, e shihte me sy të mirë politikën italiane ndaj Shqipërisë. Sipas tij, Italia ishte kombi më i përshtatshëm për të ushtruar një lloj protektorati, sepse nuk ishte e huaj për Shqipërinë, as nga fuqia, as nga mirëpritja që u kishte dhënë arbëreshëve për më shumë se pesë shekuj, të cilët vazhdonin të jetonin në paqe në gjirin e saj. Përveç kësaj, Adriatiku shfaqej si një det i përbashkët italo-shqiptar, dhe përballë rënies së Perandorisë Osmane, Italia, sipas Lorecchio-s, kishte një rol të rëndësishëm për të luajtur në Shqipëri.³⁷

Ndikimi i politikës italiane te shqiptarët u rrit edhe për arsye objektive. Shqipërisë i mungonin kushtet më elementare, ndërsa sistemi i drejtësisë paraqiste probleme të mëdha. Magjistratët osmanë ishin të paaftë dhe të keqpaguar, dhe gjykatat funksiononin kryesisht për ata që ishin të pasur dhe mund të paguanin më shumë.³⁸ Në një vend të keqqeverisur dhe me një pakënaqësi të madhe mund të ndodhnin ndryshime të papritura. Këtë situatë, fuqitë e interesuara përpiqeshin ta shfrytëzonin për realizimin e planeve të tyre.³⁹ Në këtë kontekst, Italia

³⁴ Pietro Pastorelli, "Albania e Tripoli nella politica estera italiana durante la crisi d'Oriente del 1897", *Rivista di Studi Politici Internazionali*, Vol. 28, No. 3 (Luglio-Settembre 1961): 387.

³⁵ Michele Marchiano, *Albania e l'opera di Girolamo De Rada* (Trani: V.Vecchi, 1902), 327.

³⁶ *AQSH*, F. 98, V. 1900, D. 2, fl. 1-7. Projektstatut i shoqërisë "Shqipëria e re" për çlirimin dhe përparimin e kombit shqiptar, 1900.

³⁷ Alberto Becherelli & Andrea Carteny, *L'Albania indipendente e le relazioni italo-albanesi (1912-2012). Atti del Convegno in occasione del centenario dell'indipendenza albanese (Roma, 22 novembre 2012)*, (Roma: Nuova Cultura, 2013), 126.

³⁸ Neri, *Sonnino*, 50.

³⁹ *Po aty*.

mbështeste krijimin e një Shqipërie të pavarur, por me kusht që ajo të ishte nën kontrollin e saj ekskluziv.⁴⁰

Në vitin 1897 mes Italisë dhe Austro-Hungarisë u arrit një mirëkuptim verbal, i cili u konkretizua më 1900, në një marrëveshje të shkruar ndërmjet ministrave të Jashtëm, markezit Visconti Venosta dhe kontit Goluchowski. Sipas kësaj marrëveshjeje, mirëkuptimi nuk pengonte: 1) që Austro-Hungaria të ushtronte edhe në Shqipëri misionin e saj tradicional për të mbrojtur dhe për të subvencionuar klerin katolik; 2) që, si Italia, ashtu edhe Austro-Hungaria të kishin aty shkolla, të promovonin interesat e tyre ekonomikë, tregtarë, industrialë dhe të lundrimit; të vendosnin konsuj e agjentë tregtarë dhe, për këtë qëllim, zyra postare nën vëzhgimin e agjentëve konsullorë.⁴¹ Marrëveshja austro-ruse për çështjen maqedonase krijoi frikë te politika italiane. Italia ishte e pasigurt nëse zgjidhja përfundimtare e këtij problemi do të lejonte ruajtjen e *status quo*-së në Shqipëri. Përballë kësaj situatë, ambasadori italian në Stamboll shprehu mendimin se ishte në interes të Italisë të parandalonte zhvillimet dhe të përgatiste, përmes marrëveshjeve të përshtatshme me Austro-Hungarinë, një gjendje në Shqipëri që t'u përgjigjej më mirë marrëveshjeve ekzistuese.⁴² Një pjesëmarrje italiane do të ishte një element i vlefshëm për ta detyruar Perandorinë Osmane të pranonte kërkesat e bëra dhe, njëkohësisht, do të forconte, në vend që të dobësonte, marrëveshjen austro-ruse.⁴³

Në fillim të shek. XX, aksioni italian në brigjet shqiptare u intensifikua gjithnjë e më shumë. Në vitin 1902, në shtypin austro-hungarez u botuan lajme lidhur me një ekspeditë që trupat vullnetare të Ricciotti Garibaldi-t (Riçioti Garibaldi) do të zbarkonin në bregdetin

⁴⁰ Massimo Borgogni, *Tra continuità e incertezza. Italia e Albania (1914-1939). La strategia politico-militare dell'Italia in Albania fino all'Operazione «Oltre Mare Tirana»* (Milano: Franco Angeli, 2007), 3.

⁴¹ *I Documenti Diplomatici Italiani* (më tej: DDI), Terza serie: 1896-1907, vol. VI (1 gennaio – 30 giugno 1902), a cura di Enrico Serra (Roma: Libreria dello Stato, 1985), dok. nr. 579. Telegram i ambasadorit italian në Vjenë, Nigra, drejtuar ministrit të Jashtëm në Romë, Prinetti, Vjenë, 19 qershor 1902.

⁴² DDI, Terza serie: 1896-1907, vol. VII (1 luglio 1902 – 3 novembre 1903), a cura di Giampiero Carocci (Roma: Libreria dello Stato, 2000), dok. nr. 387. Telegram i ambasadorit italian në Stamboll, Malaspina, drejtuar ministrit të Jashtëm në Romë, Morin, Stamboll, 2 mars 1902.

⁴³ *Po aty*, dok. nr. 57. Telegram i ambasadorit italian në Vjenë, Nigra, drejtuar ministrit të Jashtëm në Romë, Morin, Vjenë, 4 gusht 1902.

shqiptar. Ky zbarkim justifikohej me ndihmën që, gjoja, këto trupa do t'i jepnin kryengritjes antiosmane të popullit shqiptar, por në të vërtetë kjo politikë ishte pjesë e rivalitetit austro-italian në brigjet shqiptare. Kjo vihet re edhe nga një deklaratë e Garibaldit për gazetën "La Stampa", ku ndër të tjera ai shprehej se në Ballkan po ndodhnin zhvillime të reja, të cilat lidheshin direkt me interesat e Italisë. Madje, ai deklaroi hapur se ekspansioni i Austro-Hungarisë në Maqedoni duhej ndalur me çdo kusht, qoftë edhe duke pushtuar Shqipërinë. Sipas tij, Italia nuk duhej të lejonte kurrë dominimin e Austro-Hungarisë mbi popujt e Ballkanit.⁴⁴

Në përpjekjet për të përforcuar ndikimin kulturor dhe politik në Shqipëri, përfshihej edhe udhëzimi i ministrit të Jashtëm të Italisë, Giulio Prinetti, drejtuar konsullit të Përgjithshëm në Shkodër, Leoni, më 1902. Në këtë udhëzim theksohej se mbrojtja e priftërinjve italianë ishte përfundimisht çështje e qeverisë italiane dhe e përfaqësive të saj konsullore jashtë shtetit.

Për t'i dalë përpara rrezikut që një nga kuvendet e Shkodrës, me shumicë italianësh, të kërkonte mbrojtje nga Italia, qeveria austro-hungareze vendosi të përcaktonte qëndrimin e saj lidhur me çështjen shqiptare. Për këtë arsye, në vitin 1902 u zhvilluan bisedime të gjata mes Italisë dhe Austro-Hungarisë.

Ndërkohë që qeveria italiane i përmbahej pikëpamjes se kishte të drejtë, madje edhe detyrë, të mbronte jo vetëm çdo prift dhe shoqata klerikësh të kombësisë italiane, por edhe çdo klerik vendës, kur kjo mbrojtje kërkohej, Austro-Hungaria propozoi një marrëveshje në bazë të katër pikave të mëposhtme:

1) Proteksioni i shoqatave fetare dhe i instituteve, si dhe i çdo pjesëtari të urdhrat me cilësinë e priftit t'i përkiste përfundimisht pushtetit mbrojtës;

2) Në çështjet krejtësisht personale të klerikëve italianë, Austro-Hungaria njihte kompetencat e Italisë;

3) Në rast të cenimit të nderit, lirisë, pronës, trupit dhe jetës së një kleriku me kombësi italiane, i cili ndodhej nën mbrojtjen austro-hungareze, monarkia mbretërore-perandorake shpallej e gatshme për një ndërhyrje;

⁴⁴ Ennio Maserati, *Momenti della questione adriatica (1896-1914): Albania e Montenegro tra Austria ed Italia* (Udine: Del Bianco, 1981), 464.

4) Paraqitja e akteve zyrtare të klerikëve me kombësi italiane pranë instituteve të monarkisë mbretërore perandorake do të kryhej vetëm nëpërmjet autoriteteve konsullore austriake.⁴⁵

Gjithsesi, raportet austro-italiane lidhur me çështjen shqiptare erdhën duke u tensionuar. Ambasadori italian në Vjenë njoftoi ministrin e Jashtëm për rrezikun që një lëvizje italiane pro Shqipërisë mund të shkaktonte për marrëdhëniet e mira me Austro-Hungarinë. Njëkohësisht, ai tërhoqi vëmendjen e paraardhësit të tij për qëndrimin e konsujve italianë, raportet e të cilëve tregonin njëfarë ngazëllimi të tepruar, dhe sugjeroi që informacioni të merrej në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kjo mund të realizohej përmes dërgimit të ndonjë personi të besueshëm për të vlerësuar gjendjen reale, sidomos lidhur me akuzat e formuluar kundër konsujve austro-hungarezë, të cilët përmendeshin si zbatues të planeve hegjemoniste në Shqipëri, në kundërshtim me marrëveshjet e arritura midis dy fuqive. Por ky sugjerim nuk u realizua. Në zbatim të udhëzimeve të ministrit të Jashtëm, ambasadori italian në Vjenë i tërhoqi vëmendjen kontit Goluchowski për gjendjen e mosbesimit të ndërsjellë midis konsujve italianë dhe austro-hungarezë në Shqipëri. Ai u përpoq të krijonte një klimë bashkëpunimi midis përfaqësive konsullore. Konti Goluchowski shprehu besimin e tij të plotë te ministri i Jashtëm i Italisë dhe nuk vuri në dyshim vendosmërinë e tij për të respektuar me ndershmëri marrëveshjen e arritur midis dy qeverive për Shqipërinë. Megjithatë, ai dyshonte se qeveria italiane do të arrinte të rikthente në rrugën e drejtë opinionin publik italian, i cili, lidhur me çështjen shqiptare, dukej i devijuar. Sipas tij, kjo çështje nuk ekzistonte ose ekzistonte vetëm në gjendje latente deri para pak vjetësh, kur shtypi italian filloi propagandën pro Shqipërisë, jo për të mbështetur një autonomi shqiptare të pavarur nga çdo hegjemoni e huaj, por për të nënshtruar vendin ndaj ndikimit italian. Konsujt italianë kishin vepruar në mënyrë intensive, ndërsa qeveria austro-hungareze, e cila ndiqte interesat e saj tradicionale, nuk dëshironte pushtimin e Shqipërisë, por as aneksimin e saj nga fuqi të tjera. Ajo nuk mendonte aspak t'i asimilonte shqiptarët, por t'i kundërvihej italianizimit të tyre. Ky ishte edhe burimi i konfliktit. Ambasadori italian evitoi me kujdes çdo kritikë ndaj pikëpamjeve të kontit Goluchowski. Duke lënë mënjanë të shkuarën, ai përsëriti lutjen që të shqyrtohej se çfarë mjetesh mund të përdroreshin për

⁴⁵ Wernicke, *Teodor Ipen*, 81-82.

t'i dhënë zgjidhje gjendjes aktuale, qoftë përmes udhëzimeve të përshtatshme për konsujt respektivë, qoftë përmes ndonjë ndryshimi në personel. Konti Goluchowski i tha se do ta mendonte. Sipas ambasadorit italian, rivendosja e besimit të dikurshëm ishte shumë e vështirë, pasi shtysa antiaustriake gjente terren në shtypin dhe shkollat italiane – dy forca që nuk ishte e lehtë për qeverinë italiane t'i mbante nën kontroll.⁴⁶ Për të shtensionuar situatën, ministri i Jashtëm italian, Prinetti, bëri përpjekje për t'u takuar me kontin Goluchowski në Zyrih. Por kohët e fundit ai kishte vërejtur se në shtypin austriak po botoheshin artikuj të frymëzuar nga njëfarë mosbesimi dhe armiqësie ndaj Italisë. Ai çuditej nga gazeta e njohur “Pester Lloyd”, e cila duhej ta kishte kuptuar nga deklaratat e tij dhe të Goluchowski-t se midis dy vendeve ekzistonin marrëveshje që përjashtonin çdo pushtim nga cilado palë. Megjithatë, këta artikuj tregonin se midis dy vendeve ekzistonte një mosbesim që duhej fashitur.⁴⁷ Për sa i përket çështjes së Shqipërisë, konti Goluchowski ishte për ruajtjen e *status quo*-së territoriale.⁴⁸ Nga ana tjetër, ministri i Jashtëm italian mendonte se duhej zhvilluar një shkëmbim mendimesh për të unifikuar udhëzimet e përbashkëta që do t'u jepeshin konsujve respektivë në Shqipëri, në mënyrë që ata të mbanin një kontakt të përzemërt dhe të vepronin në mënyrë efektive pranë autoriteteve vendore, në interes të shqiptarëve. Gjithçka me synimin për të siguruar gjithnjë e më mirë *status quo*-në, që ishte pika e parë e marrëveshjes midis dy qeverive.⁴⁹

Pavarësisht këmbënguljes italiane, konti Goluchowski nuk e shihte të arsyeshme një shkëmbim mendimesh mbi Shqipërinë. Ai këmbëngulte mbi pikat vijuese:

1. Gjendja territoriale dhe politike e Shqipërisë nuk ishte në diskutim; vilajeti i Shkupit, ku gjendeshin shqiptarë të përzier me sllavë, nuk bënte pjesë në provincat shqiptare, por në Maqedoni;

⁴⁶ *DDI*, Terza serie: 1896-1907, VII, dok. nr. 610. Telegram i ambasadorit italian në Vjenë, Nigra, drejtuar ministrit të Jashtëm në Romë, Vjenë, 9 korrik 1902.

⁴⁷ *Po aty*, dok. nr. 84. Telegram i ministrit të Jashtëm në Romë, Prinetti, drejtuar ambasadorit italian në Vjenë, Nigra, Romë, 25 gusht 1902.

⁴⁸ *Po aty*, dok. nr. 428. Telegram i ambasadorit italian në Vjenë, Nigra, drejtuar ministrit të Jashtëm në Romë, Morin, Vjenë, 5 prill 1903.

⁴⁹ *Po aty*, dok. nr. 429. Telegram i ministrit të Jashtëm në Romë, Morin, drejtuar ambasadorit italian në Vjenë, Nigra, Romë, 6 prill 1903.

2. Qeveria austro-hungareze synonte të mbetej besnike ndaj angazhimeve të marra ndaj Italisë dhe fuqive të tjera, sipas Traktatit të Berlinit, traktatit të aleancës dhe marrëveshjes austro-italiane mbi Shqipërinë. Prandaj nuk shihte ndonjë nevojë për konfirmim të mëtejshëm;

3. Qeveria austro-hungareze nuk hiqte dorë nga e drejta e njohur nga Traktati i Berlinit për të shtyrë okupimin deri në Mitrovicë; megjithatë, nuk synonte të përfitonte prej saj, veçse nëse kërcënohej kufiri që mbahej aktualisht i pushtuar, i cili ishte i qetë;

4. Nëse ngjarjet do ta detyronin qeverinë austro-hungareze të shtrinte okupimin, ajo duhej të arrinte një marrëveshje me Perandorinë Osmane sipas dispozitave të Traktatit të Berlinit dhe t'ua njoftonte këtë gjë fuqive firmëtare. Megjithatë, konti Goluchowski përsëriste se synonte të shmangte një skajshmëri të tillë dhe se sinqeriteti i këtyre qëllimeve, të diktuar nga interesat e Austro-Hungarisë, nuk mund të vihej në dyshim;

5. Kërcënimi që ambasadorët e Austro-Hungarisë dhe të Rusisë kishin bërë për t'u tërhequr, nëse Perandoria Osmane hezitonte ndaj politikës së ndjekur deri atëherë, duhej interpretuar në kuptimin se, në këtë rast, Austro-Hungaria dhe Rusia do të konsideroheshin të lira nga premtimi për të ushtruar veprim diplomatik pranë qeverisë së Serbisë dhe Bullgarisë, për t'i penguar ato të favorizonin kryengritjen;

6. *Status quo*-ja në Ballkan, e përcaktuar nga Traktati i Berlinit, ishte themeli i politikës së Austro-Hungarisë dhe i fuqive të tjera. Ajo nuk mund të ndryshohej pa pëlqimin e tyre të përbashkët. Konti Goluchowski nuk parashikonte një ndryshim të tillë dhe nuk e shihte të arsyeshme të spekulohet para kohe mbi hipoteza të pamundura ose të largëta.⁵⁰

Por, me kalimin e viteve, politikës italiane iu shtuan edhe konkurrentë të tjerë në brigjet e Adriatikut. Më 10 qershor 1903, Mbreti serb Aleksandër Obrenoviç u vra gjatë një revolucioni, në të cilin ishin të përfshirë edhe agjentë rusë. Ai u zëvendësua nga Pjetri I Karagjeorgjeviç dhe një qeveri nacionaliste me prirje të theksuara rusofilë, gjë që shkaktoi rritjen e armiqësisë ndaj Austro-Hungarisë dhe Perandorisë Osmane. Qeveria e re serbe synonte të siguronte një dalje në Adriatik nëpërmjet

⁵⁰ *Po aty*, dok. nr. 454. Telegram i ambasadorit italian në Vjenë, Nigra, drejtuar ministrit të Jashtëm në Romë, Morin, Vjenë, 26 prill 1903.

territorit shqiptar. Mirëpo, kjo ambicie binte në kundërshtim me interesat e Italisë, e cila e konsideronte Adriatikun si një det italian dhe shqiptar.

Pas marrëveshjes së Mürzsteg-ut më 2 tetor 1903, mosbesimi mes Italisë dhe Austro-Hungarisë u rrit ndjeshëm.⁵¹ Projekti i reformave në Maqedoni shihej me xhelozë nga Italia.⁵² Ministri i Jashtëm Prinetti protestoi në Vjenë, duke kërkuar që edhe Italia të kishte aksionet e veta. Kjo e shtyu Vjenën të zbuste qëndrimin e saj, duke lejuar vendosjen e një gjenerali në krye të xhandarmërisë. Megjithatë, ky lëshim u prit me rezerva, sepse mund të rritej influenca e Italisë në zonat e banuara me shqiptarë.⁵³ Qëllimi kryesor i Italisë ishte të kundërshtonte influencën austro-hungareze, të paktën në Shqipërinë e Jugut.⁵⁴

Në fjalimin që ministri i Jashtëm, Tomaso Tittoni, mbajti në parlament më 15 dhjetor 1903, ai deklaroi se politika ballkanike e Romës bazohej në ruajtjen e *status quo*-së së Shqipërisë dhe në zgjerimin e influencës ekonomike në brigjet e Adriatikut. Kjo influencë u reflektua në shtimin e linjave dhe transportit detar.⁵⁵ Në aspektin ekonomik, Shqipëria nuk përbënte një zonë me interes të veçantë për tregun dhe kapitalin italian. Këtë e vërtetoi edhe fjalimi i Tittoni-t në parlament më 14 maj 1904, ku theksoi se Shqipëria vetë nuk kishte ndonjë rëndësi të madhe, por portet dhe brigjet e saj do t'i siguronin Italisë, ose Austro-Hungarisë, supremacinë e padiskutueshme në Adriatik.⁵⁶

Çështja shqiptare i kushtëzoi gjatë gjithë kohës raportet austro-italiane. Në një bisedë me ambasadorin e ri italian në Vjenë, konti Golukowski deklaroi se Austro-Hungaria nuk kishte synim të pushtonte Shqipërinë. Qëllimi i saj ishte vetëm zhvillimi moral dhe material i vendit; megjithatë, nuk donte që ajo të pushtohej nga Italia dhe që kjo e fundit të përpiqej ta italianizonte, siç i kishte bërë të ditur më herët

⁵¹ Stavro Skendi, *Zgjimi kombëtar shqiptar 1878-1912* (Tiranë: Phoenix & Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, 2000), 232.

⁵² Giuseppe Schiró, *Gli albanesi e la questione balcanica* (Napoli: Ferd. Bideri, 1904), 485-490.

⁵³ Augusto Torre, *La politica estera dell'Italia dal 1870 al 1896. Lezioni tenute nell'Università di Bologna durante l'anno accademico 1958-59* (Bologna: Casa Editrice prof. Riccardo Patron, 1959), 220.

⁵⁴ Amedeo Giannini, *L'Albania dall'indipendenza all'unione con l'Italia, 1913-1939* (Milano: Istituto per gli studi di politica nazionale, 1939), 11.

⁵⁵ Tommaso Tittoni, *Italy's foreign and colonial policy* (London: Smith, Elder & Co, January 1, 1914), 19.

⁵⁶ *Po aty*.

Shkëlqesisë së Tij, markezit Visconti Venosta dhe paraardhësit të tij.⁵⁷ Ky ishte mendimi jo vetëm i qeverisë, por edhe i burrave të shtetit austriak.⁵⁸

Më 29 mars 1904, gazeta “Tribuna” njoftonte se në shtëpinë e Riçioti Garibaldit ishte formuar “Këshilli Shqiptar i Italisë” (“Consiglio Albanese d’Italia”). Ky Këshill kishte si qëllim të organizonte shqiptarët e Italisë, të vendoste kontakte me shoqëritë shqiptare jashtë atdheut për të koordinuar veprimtarinë e tyre, të forconte lidhjet e shqiptarëve me mëmëdheun dhe të përpiquej që Italia t’i mbështeste aspiratat e popullit shqiptar. Këshilli kishte zgjedhur si kryetar gjeneral R. Garibaldin. Gazeta botonte edhe emrat e anëtarëve, të cilët ishin personalitete nga fusha të ndryshme të jetës politike, ushtarake, juridike etj.⁵⁹ Sipas drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, të pranishëm ishin 14 veta, ndër të cilët drejtori i gazetës “La Nazione Albanese” të Romës, Anselmo Lorecchio; drejtori i periodikut “La Nuova Albania” të Napolit, avokati Lusi; kryetari i shoqatës shqiptare të Palermos, Musacchio; publicisti nga Roma, Manlio Dominici; gjenerali Danis dhe koloneli Schirò. Sipas informacioneve të policisë italiane, në këtë takim u vendos që partia shqiptare në Itali të merrte një shtytje të re dhe të fuqishme, në mënyrë që të ishte e gatshme për çdo eventualitet, pasi ekuilibri në Ballkan mund të trazohej nga një moment në tjetrin. R. Garibaldi deklaroi se, sapo të shpërthenin armiqësitë në Gadishullin Ballkanik, do të organizonte një ushtri vullnetarësh për të pushtuar Trenton dhe Triesten. Si pjesë e kësaj strategjie, u vendos shpërndarja e një proklamate sekrete në të gjithë Italinë, me qëllim organizimin e nënkomiteteve lokale dhe krijimin e çetave të vullnetarëve të gatshëm të merrnin armët sapo të jepej thirrja e parë. Me këtë proklamatë rekomandohej gjithashtu mbajtja e konferencave të komitetit “Pro Albania”, zhvillimi i propagandës përmes shtypit dhe, mbi të gjitha, hapja e abonimeve për mbledhjen e fondeve.

⁵⁷ *DDI*, Terza serie: 1896-1907, vol. VIII (3 novembre 1903 – 28 marzo 1905), a cura di Giampiero Carocci (Roma: Libreria dello Stato, 2007), dok. nr. 212. Telegram i ambasadorit italian në Vjenë, Avarna, drejtuar ministrit të Jashtëm në Romë, Tittoni, Vjenë, 25 shkurt 1904.

⁵⁸ *Po aty*, dok. nr. 219. Telegram i ambasadorit italian në Vjenë, Avarna, drejtuar ministrit të Jashtëm në Romë, Tittoni, Vjenë, 27 shkurt 1904.

⁵⁹ *Haus, Hof und Staatsarchiv Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej: HSt.A.P.A.A), në *Arkivin e Institutit të Historisë – Tiranë* (më tej: *AIH*), Vj. 13-4-465. Raport i ambasadorit austro-hungarez në Romë, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Romë, 5 prill 1904.

Në fund, u procedua me emërimin e sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të komitetit “Pro Albania”, Manlio Bennici. Në kuadër të këtij aksioni, së shpejti një deputet – me shumë gjasa Luigi Gaetani di Laurenzana – do të fliste në parlament lidhur me çështjen shqiptare.⁶⁰

Delegacioni i Federatës Kombëtare Popullore “Pro-Italisë irredente” njoftonte se R. Garibaldi, në cilësinë e tij si delegat i organizimit të kësaj federate, kishte marrë përsipër nismën për të organizuar lëvizjen e shqiptarëve në Itali dhe për të koordinuar aspiratat e popullit italian me ato të popullit shqiptar, që synonin mbrojtjen e integritetit të tij kombëtar. Për këtë qëllim, R. Garibaldi u kishte dërguar ftesa personaliteve më të shquara të kolonive shqiptare në Itali, për krijimin e një këshilli shqiptar në Romë. Me këtë nismë u bashkuan njëzet emra të njohur. Në mbledhjen e parë, që ishte zhvilluar në shtëpinë e R. Garibaldit, u vendos krijimi i Këshillit Shqiptar të Italisë. Pasi e zgjodhi si kryetar, Këshilli i dha R. Garibaldit kompetencat për të vënë në jetë objektivat e mësipërm, duke i lënë për mbledhjen e ardhshme propozimet dhe argumentet e tjera lidhur me këtë çështje.⁶¹ Pak ditë më pas, sekretari i Këshillit Shqiptar i dërgoi një letër Shahin Kolonjës, duke i shprehur mirënjohjen për veprimtarinë e tij në çështjen kombëtare dhe duke e informuar për këtë zhvillim. Gjithashtu, në emër të Këshillit, ai kërkonte një numër sa më të madh adresash të shqiptarëve të mërguar në Bullgari, Egjipt, Serbi, Greqi, Rumani dhe Amerikë, pasi kishte botuar një numër të konsiderueshëm të Kalendarit Kombiar. Në fund të kësaj letre, sekretari Manlio Beniçi shprehte bindjen se me krijimin e Këshillit shpresonte të realizohej diçka serioze. Anëtarët e tij ishin personalitete të kolonive shqiptare në Itali, ndërsa kryetar ishte një burrë i shquar, gjeneral R. Garibaldi.⁶² Në një korrespondencë të kohës theksohej se në

⁶⁰ *DDI*, Terza serie: 1896-1907, VIII, dok. nr. 323. Telegram i drejtorit të Përgjithshëm të Sigurisë Publike, Leonardi, drejtuar ministrit të Jashtëm në Romë, Tittoni, Romë, 10 prill 1904.

⁶¹ *HHSSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 13-4-443. Njoftim i delegacionit të Federatës Kombëtare Popullore “Pro Italisë irredente”, Romë, 6 prill 1904.

⁶² *AQSH*, F. 98, V. 1904, D. 6, fl. 1. Letër e dërguar një personi, me të cilën njoftohej se në Romë ishte krijuar një shoqëri shqiptaro-italiane me garibaldianë, me qëllim që të ndihmonte popullin shqiptar, Romë, 8 prill 1904; *HHSSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 13-4-445. Letër e sekretarit të Këshillit Shqiptar të Italisë, Manlio Bennicis, drejtuar Mit`hat Frashërit, Romë, 8 prill 1904.

Romë ishte krijuar një shoqëri shqiptaro-italiane me garibaldianë, e cila synonte të ndihmonte popullin shqiptar.⁶³

Krijimi në mars të vitit 1904 i “Këshillit Italo-Shqiptar” (“Consiglio Albanese d’Italia”) nga R. Garibaldi, nën varësinë e “Federatës Kombëtare për Italinë irredente” (“Federazione Nazionale per Italia Irredenta”),⁶⁴ tregon qartë se synimi kryesor i vullnetarëve italianë ishte ekspansioni dhe rritja e influencës së Italisë ndaj politikës austro-hungareze në Ballkan.⁶⁵ Në vitin 1897, R. Garibaldi kishte luftuar në Greqi përkrah forcave greke kundër osmanëve.⁶⁶ Megjithatë, lëvizja garibaldiane nuk i rezistoi presionit të Austro-Hungarisë. Papritur, R. Garibaldi u tërhoq nga plani i ndërhyrjes. Sipas tij, rreziku me të cilin do të përballeshin ishte shumë më i madh sesa parashikohej dhe binte në kundërshtim me politikën e ndjekur nga Italia.⁶⁷

Ndërsa, në një memorandum dërguar shqiptarëve të Italisë së Jugut, R. Garibaldi nënvizonte se Italia duhej të ndihmonte zhvillimin moral, intelektual dhe ekonomik të popullit shqiptar. Ai theksonte se vendi fqinj duhej të ishte për Shqipërinë ajo që Anglia kishte qenë për italianët gjashtëdhjetë vjet më parë. Pas Traktatit të Berlinit, i njohur si “funerali i kombësisë”, popujt e Ballkanit fituan pavarësinë, përveç shqiptarëve, të cilëve nuk iu njoh ekzistenca kombëtare. Sipas Garibaldit, kjo binte ndesh me traditat dhe historinë e këtij kombi të lavdishëm. Ai e konsideronte dhënien e hinterlandit shqiptar, përfshirë vilajetin e Manastirit, si një fitore të politikës italiane dhe një hap drejt krijimit të një sfere të ndikimit italian në të gjithë Shqipërinë bregdetare, përgjegjësi e madhe përpara popullit shqiptar. Italia, sipas tij, nuk kishte qëllime

⁶³ AQSH, F. 98, V. 1904, D. 7, fl. 1. Letër e Ricciotti Garibaldi-t, drejtuar italianëve për t’u bashkuar me vëllezërit e tyre arbëreshë dhe për t’i ardhur në ndihmë Shqipërisë për çlirimin e saj nga pushtuesit turq, 1 nëntor 1904.

⁶⁴ Po aty, F. 98, V. 1904, D. 5, fl. 1. Komunikatë e delegacionit të Federatës Nazionale Popullore mbi iniciativën e Ricciotti Garibaldi-t për organizimin e lëvizjes shqiptaro-italiane dhe themelimin e një këshilli shqiptar me emrin “Këshilli i shqiptarëve të Italisë”, Romë, 1904.

⁶⁵ Francesco Guida, “Ricciotti Garibaldi e il movimento nazionale Albanese”, in *Archivio storico italiano*, nr. 507 (1981): 102.

⁶⁶ Francesco Valori, *Dizionario delle Battaglie* (Varese-Milano: Casa Editrice Ceschina, 1968), 178. Ndërsa në vitin 1912, R. Garibaldi, së bashku me pesë fëmijët e tij, mori pjesë në Luftën e Janinës, në krah të ushtrisë greke. Antonio Biagini, *L’Italia e le guerre balcaniche* (Roma: Ufficio storico S.M.E., 1990), 127.

⁶⁷ Guida, “Ricciotti Garibaldi”, 126.

okupimi, por synonte t'i kundërvihet politikës austro-hungareze. Ajo duhej të ndërmjetësonte në Stamboll, në mënyrë që reformat e realizuara në vilajetet e Kosovës, Manastirit dhe Selanikut – ku pjesa dërrmuese e popullsisë ishte shqiptare – të shtriheshin edhe në Shkodër dhe Janinë. Garibaldi shtonte se disa kohë më parë sulltani donte të lejonte reformimin e gjashtë vilajeteve të Turqisë europiane, por ky proces ishte penguar nga Austro-Hungaria dhe Rusia. I njëjti propozim mbështetej edhe nga Anglia, e cila kishte qenë gjithmonë një mike e sinqertë e Shqipërisë.

Një pikëpamje interesante e R. Garibaldit ishte se, ashtu si Rusia kishte mbështetur projektin e krijimit të Ekzarkatit bullgar, edhe Italia duhej të përkrahte dëshirën e popullit shqiptar për krijimin e një ekzarkati që të bashkonte shqiptarët ortodoksë, të cilët, në mungesë të një institucioni të tyre, detyroheshin të regjistroheshin në kishën greke ose bullgare, gjë që i dëmtonte rëndë në aspektin kombëtar. Sipas tij, pa dashur të ndërhynte në punët e brendshme të Perandorisë Osmane, Italia, në emër të qytetërimit dhe humanizmit, duhej të përkrahte krijimin e shkollave shqiptare. Kjo për shkak se, deri atëherë, qeveria osmane nuk kishte lejuar hapjen e tyre, megjithëse shqiptarët ishin të gatshëm t'i financonin vetë. Në këtë mënyrë, shqiptarët e arsimuar do të ktheheshin në një barrierë të pakapërcyeshme ndaj lakmive grabitqare të Austro-Hungarisë, e cila, e nxitur nga pangjermanizmi, po avanconte drejt Lindjes.

R. Garibaldi vlerësonte popullsinë shqiptare në Italinë e Jugut, e cila ishte e shpërndarë në shtatëdhjetë koloni dhe numëronte deri në 250 000 banorë. Sipas tij, ajo ruante të paprekur gjuhën shqipe, zakonet, traditat, këngët popullore, kostumet, ndërsa mendja e saj ishte e drejtuar te vëllezërit në Shqipëri, lirinë e të cilëve e dëshironte me gjithë shpirt. Kishte ardhur koha që kjo popullsi, e cila kishte dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për çlirimin dhe bashkimin e Italisë, të angazhohej për mëmëdheun e saj. Një provë për këtë ishte krijimi i Këshillit Shqiptar të Italisë, i formuar kohët e fundit nga një grup burrash të njohur nga kolonitë shqiptare. Programi i tyre ishte shumë i qartë dhe i prerë: “Shqipëria e shqiptarëve”. Ata synonin t'u vinin në ndihmë vëllezërve të tyre, kur këta, shpejt ose vonë, të detyroheshin të afërmonin të drejtën e tyre të kombësisë. Ky Këshill, i drejtuar nga gjeneral R. Garibaldi, kishte për qëllim organizimin e italo-shqiptarëve, në mënyrë që të lidhur dhe të bashkuar të kishin një përfaqësi të tyre në Parlamentin Italian, e cila do

të kontribuonte në zhvillimin ekonomik, kur marrëdhëniet midis Italisë dhe Shqipërisë të konsolidoheshin edhe më shumë. Nisma gjeti mbështetjen e patriotëve dhe të rinjve italo-shqiptarë, këshillave komunalë etj., për ta zbatuar këtë program, i cili synonte gjithashtu krijimin e një unaze lidhjeje midis Italisë dhe Shqipërisë.

Italia duhej ta përdorte këtë element shumë të rëndësishëm, si për personelin e shkollave italiane, ashtu edhe për atë të postave dhe konsullatave në Shqipëri. Sipas Garibaldit, kjo do t'i mundësonte që të lehtësonte mërgimin e italo-shqiptarëve në këto territore, ndërkohë që ata shpesh detyroheshin të kërkonin punë në Amerikën e largët. Ai merrte si shembull bejlerët shqiptarë të Maqedonisë, të cilët për të punuar tokat e tyre shfrytëzonin fshatarët bullgarë, ndërkohë që mund të punësonin italo-shqiptarët. Po ashtu, ai vlerësonte se qeveria italiane duhej të bënte më shumë për shqiptarët e Italisë. Ajo duhej të krijonte një katedër të gjuhës shqipe në Universitetin e Romës, ashtu siç kishte krijuar Austro-Hungaria në Zarë dhe në Universitetin e Vjenës. Garibaldi shpresonte që ministri i Jashtëm të merrte në konsideratë lutjen e tij për përmirësimin e kushteve ekonomike, arsimore dhe intelektuale të popullit shqiptar.

Megjithatë, ministri i Jashtëm Tittoni i dha një përgjigje interesante këtij memorandumit. Ai deklaroi se gjatë diskutimeve ishte folur me shumë fantazi për ekspedita italiane në Shqipëri dhe për pushtime austriake në Maqedoni. Mirëpo, asnjë nga të dyja shtetet nuk kishte në plan pushtime ose ndarje kufomash; politika e tyre nuk shkonte më larg se kaq. Si Italia, ashtu dhe Austro-Hungaria ishin për ruajtjen e *status quo*-së politike dhe, nëse kjo nuk do të ishte e mundur pavarësisht përpjekjeve të tyre, duhej të mbizotëronte parimi i autonomisë mbi bazën e kombësive. R. Garibaldi e interpretoi këtë përgjigje si një konfirmim të programit të tyre për Shqipërinë dhe u bëri thirrje italo-shqiptarëve që të organizoheshin për të mbrojtur vendin e tyre nga kërcënimi austro-hungarez ose çdo rrezik tjetër i mundshëm.⁶⁸

Më tej, botimi i një artikulli në gazetën “Drita”, lidhur me lëvrimin e shqipes në Institutin publik për gjuhët orientale në Vjenë, nxiti R. Garibaldin të hartonte një përgjigje të ashpër në formën e një letre. Ai theksonte se nuk kishte asnjë dyshim se populli italian ishte i gatshëm të vraponte në ndihmë të vëllezërve shqiptarë, në qoftë se ata do të luftonin

⁶⁸ *HHSSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 12-4-436. Fjalim i Kryetarit të Këshillit Shqiptar të Italisë, Ricciotti Garibaldi, Romë, 1903.

për pavarësinë e tyre. Megjithatë, kjo nuk do të ndodhte kurrë nëse shqiptarët do të viheshin nën sundimin e një fuqie të huaj, edhe sikur të ishte Italia. Garibaldi nënvizonte se organizata irredentiste garibaldiane, me të cilën lidhej shqiptarofilizmi italian, e kishte nxitur qeverinë të ndërhynte në Gadishullin Ballkanik. Kështu, edhe italianët vetë do të ishin të gatshëm ta shpëtonin Shqipërinë nga pushtimi austro-hungarez. Sipas kësaj organizate, Austro-Hungaria, e cila brenda një kohe të shkurtër pritej të shpërbëhej, ishte përfaqësuese e imperializmit feudal pangjermanik, dhe kudo ku vinte këmbët, shtypte popullsitë vendëse.

R. Garibaldi u bënte thirrje shqiptarëve që të hidhnin sytë nga Hungaria, ku të varfrit po merrnin rugën e emigrimit drejt SHBA-së, ndërsa tokat e tyre po bliheshin nga komitetet pangjermanike, duke i kthyer ato në koloni gjermane. Kështu, brenda pak vjetësh në Hungari do të kishte më tepër gjermanë sesa hungarezë. Në vlerësimin e tij, po të mos ishin italianët, e njëjta gjë do t'u ndodhte edhe shqiptarëve. Të hollat që Austro-Hungaria dërgonte në Shqipëri i shpenzonte vetëm për realizimin e interesave të saj. Nëse shqiptarët e dëshironin lirinë, atëherë ata, sipas Garibaldit, duhej të lidheshin me fqinjët e tyre. Në qoftë se Shqipëria do të binte nën sundimin e Austro-Hungarisë, ekzistenca e saj do të ishte e kërcënuar, sepse Vjena do të kënaqte, para së gjithash, orekset sllave, që ishin më të fuqishme, e më pas grekët, në mënyrë që këta të mos krijonin vështirësi në Selanik. Të gjitha këto koncesione ishin në dëm të Shqipërisë dhe shqiptarëve. Në fund të letrës, R. Garibaldi i bënte thirrje popullit shqiptar që të zgjohej, të organizohej dhe të luftonte për lirinë e tij. Për këtë, ata mund të mbështeteshin në ndihmën e garibaldianëve dhe, mbi të gjitha, te njerëzit e ndershëm.⁶⁹

Pavarësisht konkurrencës austro-italiane në fushën e arsimit, Farnezina bëri përpjekje për përmirësimin e raporteve mes konsullatave që vepronin në territorin shqiptar. Ministri i Jashtëm kërkonte nga ambasadori italian në Vjenë arritjen e një konsensusi, në mënyrë që përfaqësuesit e të dyja vendeve të merrnin udhëzime për të shmangur konkurrencën dhe kontradiktat që shpesh lindnin mes tyre dhe që binin

⁶⁹ *Po aty*, Vj. 13-1-137. Letër e Ricciotti Garibaldi-t, drejtuar gazetës "Drita", Romë, 10 nëntor 1904; O.C. Mandalari, "Ricciotti Garibaldi per la indipendenza dell' Albania. Dal Comitato pro Albania del 1904 alla spedizione garibaldini del 1911", *Camicia Rossa*, Febbraio, nr. 2, Roma, 1933, 27-32.

ndesh me mirëkuptimin e ngrohtë që ekzistonte ndërmjet dy qeverive.⁷⁰ Në takimin e ministrit të Jashtëm italian me kontin Goluchowski, biseda u përqendrua mbi çështjen maqedonase dhe atë shqiptare; zgjerimin e reformave në vilajetin e Adrianopojës; rezultatet e reformave deri në atë kohë; si dhe nevojën për të ruajtur një qëndrim të përbashkët mes Fuqive, në mënyrë që Porta e Lartë të hiqte dorë nga kundërshtimi që ende u bënte atyre. Duke kaluar te çështja shqiptare, konti Goluchowski vuri në dukje se, në ndarjen aktuale administrative të vilajeteve maqedonase, disa krahina shqiptare, si Elbasani dhe disa të tjera në vilajetin e Manastirit, ishin përfshirë arbitrarisht dhe reformat aty nuk po zbatoheshin.

Në interes të së ardhmes së Shqipërisë, ministri i Jashtëm austro-hungarez pranoi nevojën për zhvillimin e vetëdijes kombëtare, në mënyrë që, në një moment të caktuar, të bëhej i mundur formimi i një shteti autonom, që ishte qëllimi i Austro-Hungarisë dhe Italisë. Për këtë arsye, ai e konsideronte të përshtatshme që të dyja qeveritë të përpiqeshin të ngrinin në Shqipëri jo shkolla kombëtare të huaja, por shkolla thjesht shqiptare, përmes të cilave mund të arrihej ky qëllim. Konti Goluchowski theksoi se, sapo të përfundonte organizimi i xhandarmërisë dhe i financave – dy pikat kryesore të programit të Mürzsteg-ut – do të ishte e domosdoshme të kalohej në zbatimin e pjesëve të tjera të programit, veçanërisht në ndarjen territoriale të njëjësive administrative, në mënyrë që kombësitë të grupoheshin më rregullisht. Megjithatë, një ndarje e tillë, e propozuar për të eliminuar shkaqet e përplasjeve ndërmjet tyre, nuk mund të realizohej pa vështirësi, për shkak të konfuzionit të krijuar nga sistemi i ndjekur deri atëherë nga Porta e Lartë. Kjo e fundit, në vend që t'i veçonte, kishte bashkuar në një kaza të vetme kombësi të ndryshme, praktikë që kishte ushqyer pikërisht përplasjet që ende vazhdonin.⁷¹

Revolucioni Xhonturk u shfrytëzua nga Italia për të rritur influencën e saj në Maqedoni dhe Shqipëri.⁷² Roli i saj në zhvillimet

⁷⁰ *DDI*, Terza serie: 1896-1907, Vol. X (28 maggio 1906 – 31 dicembre 1907), a cura di Pietro Pastorelli, Francesco Lefebvre D'Ovidio (Roma: Libreria dello Stato, 2014), dok. nr. 71. Telegram i ministrit të Jashtëm në Romë, Tittoni, drejtuar ambasadorit italian në Vjenë, Avarna, Romë, 29 korrik 1906.

⁷¹ *DDI*, Terza serie: 1896-1907, Vol. IX (29 marzo 1905 – 28 maggio 1906), a cura di Francesco Lefebvre D'Ovidio, Pietro Pastorelli (Roma: Libreria dello Stato, 2012), dok. nr. 72. Telegram i ambasadorit italian në Vjenë, Avarna, drejtuar ministrit të Jashtëm në Romë, Tittoni, Vjenë, 5 maj 1905.

⁷² Antonio Biagini, *L'Italia e le guerre balcaniche* (Roma: Ufficio storico S.M.E., 1990), 71.

rajonale dhe ndërkombëtare, që kishin të bënin me fatin e kombit shqiptar, ishte i padiskutueshëm.

Në vitin 1911, për shkak të situatës politike në territoret shqiptare, u shtuan përpjekjet për krijimin e disa komiteteve “Pro Albania” dhe u intensifikua aktiviteti i tyre në dobi të pavarësisë së Shqipërisë.⁷³ Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luajti edhe Lufta Italo-Turke, si dhe interesat e politikës italiane për t’i shkaktuar sa më shumë probleme shtetit osman në vilajetet shqiptare. Këto përpjekje u shoqëruan me koordinimin e punës mes përfaqësuesve të Lëvizjes Kombëtare brenda dhe jashtë Shqipërisë, si edhe me një fushatë të dendur propagandistike në gazeta të ndryshme.⁷⁴ Ky aksion nuk mbeti me kaq. Në dokumentacionin e kohës vërehet një korrespondencë e gjerë mes personave të ndryshëm dhe komitetit “Pro Albania”, lidhur me gatishmërinë që shfaqnin shumë nënshtetas italianë për të ardhur si vullnetarë në Shqipëri dhe për të luftuar kundër osmanëve.⁷⁵ Nuk ka asnjë dyshim se politika dhe komitetet shqiptare të Italisë ushtruan një ndikim të rëndësishëm në kryengritjen e vitit 1911,⁷⁶ jo vetëm në Shqipërinë e Veriut, por edhe në vilajetin e Kosovës.⁷⁷ Një pjesë e armatimit dhe e municioneve të përdorura në këto kryengritje ishte kontrabanduar nga Italia.⁷⁸

⁷³ *AQSH*, F. 98, V. 1911, D. 8, fl. 1-57. Korrespondencë mes personaliteteve të ndryshme politike për krijimin e disa komiteteve “Pro Albania”, 03.01.1911-27.11.1911.

⁷⁴ *Po aty*, F. 98, V. 1911, D. 9, fl. 1-73. Korrespondencë mes personaliteteve politike italiane dhe shqiptare lidhur me programet e komiteteve “Pro Albania” dhe propagandimin e çështjes shqiptare në shtypin e kohës, 04.01.1911-20.12.1911.

⁷⁵ *Po aty*, F. 98, V. 1911, D. 10, fl. 1-128. Korrespondencë mes personaliteteve të ndryshme dhe komitetit “Pro Albania” mbi gatishmërinë e shumë shtetasve italianë për të ardhur në Shqipëri, 10.01.1911-04.09.1911.

⁷⁶ *Po aty*, F. 98, V. 1911, D. 11, fl. 1-18. Korrespondencë mes personaliteteve politike italiane dhe shqiptare mbi kryengritjet e armatosura në Shqipëri, 23.05.1911-25.09.1911.

⁷⁷ *Po aty*, F. 98, V. 1911, D. 12, fl. 1-45. Korrespondencë mes personaliteteve politike italiane dhe shqiptare mbi kryengritjet e armatosura në Malësinë e Madhe dhe në Kosovë, 02.04.1911-06.09.1911.

⁷⁸ *Po aty*, F. 98, V. 1911, D. 13, fl. 1-21. Korrespondencë e komitetit “Pro Albania” mbi kryengritjet e armatosura në Kosovë dhe në veri të Shqipërisë, si dhe për problemin e armatosjes, 12.02.1911-21.08.1911.

Një thirrje drejtuar të gjithë shqiptarëve me banim në Itali për të ndihmuar kryengritësit shqiptarë u bë edhe nga Komiteti Qendror Italo-Shqiptar në Napoli.⁷⁹

Por jo gjithmonë politika italiane ishte në mbështetje të komitetit “Pro Albania”. Në momente të caktuara, kur aktiviteti i tij dilte jashtë kontrollit dhe objektivave të politikës italiane në Shqipëri, autoritetet qeveritare ushtronin censurë ndaj propagandës në favor të çështjes shqiptare.⁸⁰ Kjo e detyroi komitetin që, me anë të një proklamate, t’i drejtohej direkt popullit italian për të ndihmuar shqiptarët kundër turqve.⁸¹ Një fushatë e tillë u shoqërua me shkrime publicistike dhe me krijimtari letrare.⁸²

Përveç armëve dhe municioneve, komiteti “Pro Albania” bëri përpjekje për të mbledhur të holla, me qëllim që t’u vinte në ndihmë kryengritësve shqiptarë me ambulanca dhe personel shëndetësor.⁸³ Ndërkohë, për trupat vullnetare të R. Garibaldit ishte përcaktuar edhe një uniformë me shenjat e saj dalluese.⁸⁴

Kryengritjet dhe situata politike në Shqipëri gjatë vitit 1911 ndikuan, në njëfarë mënyre, edhe në marrëdhëniet mes Italisë dhe Austro-Hungarisë. Ministri i Jashtëm italian ishte i mendimit se, me rastin e rihapjes së Dhomës së Deputetëve më 9 maj, do të ishte e vështirë të shmangej ose të shtyhej pa afat një diskutim mbi marrëdhëniet e Italisë me Austro-Hungarinë dhe me Perandorinë Osmane, si edhe mbi situatën në Shqipëri. Ai mendonte të bënte një deklaratë që të mos pengonte dhe as të kthente pas përmirësimin progresiv të ndjenjave të popullit italian

⁷⁹ *Po aty*, F. 98, V. 1911, D. 36, fl. 1. Thirrje e Komitetit Qendror Italo-Shqiptar, drejtuar shqiptarëve të Italisë, Napoli, 28.04.1911.

⁸⁰ *Po aty*, F. 98, V. 1911, D. 15, fl. 1-8. Letra të këmbëzera ndërmjet anëtarëve të komitetit “Pro Albania”, 29.05.1911-25.08.1911.

⁸¹ *Po aty*, F. 98, V. 1911, D. 17, fl. 1. Proklamata e komitetit “Pro Albania”, drejtuar popullit italian, 10.07.1911.

⁸² Kështu, një arbëresh shkroi një poezi në italisht, në të cilën viheshin në dukje virtytet dhe trimëritë e shqiptarëve, ndërsa u bëhej thirrje italianëve për t’i ardhur në ndihmë këtij kombi. *Po aty*, F. 98, V. 1911, D. 18, fl. 1. Poezi e shkruar nga një arbëresh në gjuhën italiane, korrik 1911.

⁸³ *Po aty*, F. 98, V. 1911, D. 19, fl. 1-128. Proklamata dhe korrespondencë mes personaliteteve të ndryshme politike shqiptare dhe italiane lidhur me përpjekjet për të ndihmuar kryengritësit shqiptarë, 06.02.1911-30.08.1911.

⁸⁴ *Po aty*, F. 98, V. 1911, D. 20, fl. 1-9. Letra të Ricciotti Garibaldi-t, drejtuar Etores Xuninit, si dhe dy përgjigje nga komiteti “Pro Albania” lidhur me dërgimin e trupave vullnetare në ndihmë të Shqipërisë, 14.02.1911-08.04.1911.

ndaj Austrisë, por, përkundrazi, të kontribuonte në ndërmarrjen e hapave të mëtejshëm në rrugën e ndjekur gjatë muajve të fundit, atë të rritjes së besimit dhe të përzemërsisë reciproke. Thelbi i kësaj deklarate ishte harmonizimi i politikave të përbashkëta. Kjo dëshmonte se Italia dhe Austro-Hungaria, përballë situatës në Shqipëri, ndiqnin jo vetëm një politikë identike, por edhe të koordinuar, si dhe ekzistonte një vullnet i fortë reciprok për ta vazhduar këtë politikë të përbashkët edhe në të ardhmen. Sipas ministrit të Jashtëm, shtyllat kryesore të deklaratës së tij duhej të ishin afërsisht këto:

➤ Të dyja Fuqitë ruanin të pacenuara marrëveshjet e tyre të mëparshme, të cilat përjashtonin çdo ambicie për aneksime territoriale në Shqipëri dhe e konsideronin si themel të politikës së tyre ruajtjen e *status quo*-së territoriale, integritetin e Perandorisë Osmane dhe të shteteve ballkanike;

➤ Të dyja shtetet ishin të bindura se kryengritja shqiptare, si edhe regjimi politik e administrativ që duhej zbatuar në atë krahinë, ishin çështje të brendshme të Perandorisë Osmane; megjithatë, ato nuk mund ta fshihnin faktin se përhapja e kryengritjes mund të krijonte ndërlikime ndërkombëtare, të cilat të dyja fuqitë aleate dëshironin dhe kishin interes t'i shmangnin;

➤ Për këtë arsye, ato ishin të gatshme të mos preknin ndjeshmëritë legjitime të perandorisë dhe të vazhdonin t'i jepnin qeverisë osmane këshilla për maturi dhe butësi, si edhe të përdornin ndikimin e tyre, në mënyrë që ajo, përmes lëshimeve të përshtatshme, respektimit të zakoneve, ndjenjave dhe traditave shqiptare, si dhe shmangies së përpjekjeve tepër të nxituara dhe të dhunshme për centralizim dhe reforma (tatime, shërbim ushtarak etj.), të përpiqej të qetësonte shpirtrat e shqiptarëve dhe të parandalonte zgjerimin ose përsëritjen e kryengritjes.

Ministri i Jashtëm italian ishte i bindur se, për shkak të ndjeshmërisë së shtetit osman, kjo deklaratë do të ishte mirë të mos bëhej. Por, duke pasur parasysh pikëpamjet e grupeve liberale në Dhomën e Deputetëve, ishte i detyruar të prononcohej lidhur me zhvillimet në politikën e jashtme. Ai i shkruante ambasadorit italian në Vjenë se ishte i bindur se Austro-Hungaria, njësoj si Italia, dëshironte të shmangej krijimi i një situatë që, për shkak të sigurisë së shtetasve të saj që banonin në Shqipëri ose për nevoja të tjera të pashmangshme, do ta detyronte të dërgonte forca ushtarake dhe detare në Shqipëri. Gjithashtu, ministri nuk dyshonte se Austro-Hungaria, njësoj si Italia, do të bënte

gjithçka për të shmangur këtë nevojë. Megjithatë, nëse ajo bëhej e pashmangshme, një veprim i izoluar nga njëra prej dy Fuqive do të ishte shumë i rrezikshëm; për këtë arsye, do të ishte e nevojshme që veprimet e tyre të koordinoheshin menjëherë. Në çdo rast, theksonte markezi Di San Giuliano, ndërhyrja e forcave ushtarake nga të dyja fuqitë aleate duhej të ishte e përkohshme dhe e kufizuar, si në aspektin territorial, ashtu edhe në atë kohor, dhe vetëm në atë masë që ishte e domosdoshme.

Përveç detyrës për të sunduar terrenin dhe opinionin politik në Vjenë, markezi Di San Giuliano kërkonte nga ambasadori italian që të ruante vigjilencën, për të mos u befasuar nga ngjarjet. Ai theksonte gjithashtu se duhej të shmangej rizgjimi tej mase i mosbesimit të lindur ndaj Austro-Hungarisë në opinionin publik italian dhe të mos bëheshin hapa prapa në rrugën e afrimit. Po ashtu, markezi Di San Giuliano kërkonte që ambasadori të jepte sugjerimet e tij lidhur me gjuhën që duhej përdorur nga ministri i Jashtëm në këtë deklaratë politike.⁸⁵ Ambasadori italian vlerësonte se ishte më mirë që të shmangej një diskutim i ri mbi marrëdhëniet me Perandorinë Osmane dhe mbi situatën në Shqipëri. Sado të kujdesshëm të ishin oratorët e ndryshëm dhe sado e prerë të ishte gjuha e ministrit të Jashtëm, ishte e vështirë që një diskutim i tillë, duke marrë parasysh mjedisin parlamentar, të mos ngjallte dyshime të reja, si në Vjenë, ashtu edhe në Stamboll. Megjithatë, ai përhëndeste përpjekjen e markezit Di San Giuliano për të bërë deklaratë të harmonizuara me qeverinë austriake, nga të cilat duhej të rezultonte se Italia dhe Austro-Hungaria, përballë situatës në Shqipëri, si edhe përballë gjithë çështjes lindore, ndiqnin një politikë të bashkënduar.

Sipas ambasadorit, kabineti i Vjenës nuk miratonte gjithçka që kishte bërë regjimi xhonturk brenda vendit dhe nuk kishte munguar t'i jepte qeverisë osmane këshilla për maturi dhe kujdes. Megjithatë, Vjena e bënte këtë në mënyrë konfidenciale dhe diskrete, sepse Perandoria Osmane, pas revolucionit, e konsideronte veten njësoj si çdo shtet tjetër europian dhe nuk toleronte ndërhyrje nga fuqitë e huaja.

Për sa i përkiste Shqipërisë, ai theksonte se Vjena mbante të pacenuara marrëveshjet me Italinë, duke përjashtuar çdo ambicie territoriale, në kundërshtim me parimin e ruajtjes së *status quo*-së dhe të

⁸⁵ *DDI*, Quarta serie: 1908-1914, Vol. VII-VIII (30 marzo 1911 – 18 ottobre 1912), a cura di Edoardo Del Vecchio (Roma: Libreria dello Stato, 2004), dok. nr. 20. Telegram i ministrit të Jashtëm në Romë, Di San Giuliano, drejtuar ambasadorit italian në Vjenë, Avarna, Romë, 23 prill 1911.

integritetit të Perandorisë Osmane. Sipas politikanëve austro-hungarezë, çdo ndërhyrje e përbashkët austro-italiane me forca ushtarake në Shqipëri jo vetëm që ishte e panevojshme, por konsiderohej edhe shumë e rrezikshme. Ata vlerësonin se transformimi rrënjësor i Kushtetutës së Perandorisë Osmane kishte ndryshuar mënyrën se si Fuqitë mund të sillleshin ndaj Portës së Lartë, duke pamundësuar ndërhyrjet sipas praktikave të regjimit të mëparshëm.

Së bashku me këto sugjerime, ambasadori italian në Vjenë i paraqiti ministrit të Jashtëm edhe një propozim për deklaratën që ai duhej të bënte në Dhomën e Deputetëve, lidhur me ngjarjet në Shqipëri dhe mbi raportet e Italisë, si me Austro-Hungarinë, ashtu edhe me Perandorinë Osmane.⁸⁶

Më 3 prill 1912, komiteti “Pro Albania” shpërndau një manifest tjetër drejtuar popullit italian, me qëllim që t’u vinte në ndihmë shqiptarëve që po luftonin kundër turqve.⁸⁷ Ky komitet e vazhdoi veprimtarinë e tij në mbështetje të Shqipërisë dhe të çështjes shqiptare edhe gjatë kryengritjeve të vitit 1912.⁸⁸ Për këtë, ai gjeti mbështetjen e disa personaliteteve të politikës italiane, të cilat e shihnin me simpati luftën e shqiptarëve për pavarësi.⁸⁹

Komiteti “Pro Albania” shihte me keqardhje gjendjen e Shqipërisë dhe dënoi me forcë synimet e Malit të Zi, si dhe përpjekjet e shteteve ballkanike për copëtimin e saj.⁹⁰ Ndërsa Komiteti Qendror Italo-Shqiptar në Napoli protestoi kundër ndërhyrjes së armatosur të këtyre shteteve për pushtimin e Shqipërisë dhe kërkoi largimin e forcave të tyre nga territori shqiptar.⁹¹

⁸⁶ *Po aty*, dok. nr. 24. Telegram i ambasadorit italian në Vjenë, Avarna, drejtuar ministrit të Jashtëm në Romë, Di San Giuliano, Vjenë, 30 prill 1911.

⁸⁷ *AQSH*, F. 98, V. 1912, D. 22, fl. 1. Manifest i komitetit “Pro Albania”, drejtuar popullit italian, 3 prill 1912.

⁸⁸ *Po aty*, F. 98, V. 1912, D. 23, fl. 1-7. Korrespondencë mes komitetit “Pro Albania” dhe personave të ndryshëm mbi krijimin e komiteteve në ndihmë të Shqipërisë, 11.06.1912-06.07.1912.

⁸⁹ *Po aty*, F. 98, V. 1912, D. 25, fl. 1-5. Korrespondencë mes komitetit “Pro Albania” dhe personave të ndryshëm për luftën e popullit shqiptar, 09.03.1912-03.07.1912.

⁹⁰ *Po aty*, F. 98, V. 1912, D. 26, fl. 1. Letër mbi gjendjen në Shqipëri dhe synimet e shteteve ballkanike për copëtimin e territoreve shqiptare, 21.02.1913.

⁹¹ *Po aty*, F. 98, V. 1912, D. 38, fl. 1-3. Letër e Komitetit Qendror Italo-Shqiptar, Napoli, 26.12.1912.

Interesat e Italisë ndaj Shqipërisë u pasqyruan edhe në qëndrimin e saj diplomatik gjatë Konferencës së Ambasadorëve në Londër. Në këto bisedime, së bashku me Austro-Hungarinë, ajo luajti një rol të rëndësishëm në krijimin e shtetit të pavarur shqiptar dhe në mbajtjen larg të çdo fuqi tjetër nga brigjet e Adriatikut.

Burime dhe literatura:

Arkivat

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)

Arkivi i Institutit të Historisë, Tiranë (AIH)

Burime dokumentare të botuara:

Documenti (I) Diplomatici Italiani (DDI), Terza serie: 1896-1907, Vol. VI (1 gennaio – 30 giugno 1902), a cura di Enrico Serra (Roma: Libreria dello Stato, 1985)

Documenti (I) Diplomatici Italiani, Terza serie: 1896-1907, Vol. VII (1 luglio 1902 – 3 novembre 1903), a cura di Giampiero Carocci (Roma: Libreria dello Stato, 2000)

Documenti (I) Diplomatici Italiani, Terza serie: 1896-1907, Vol. VIII (3 novembre 1903 – 28 marzo 1905), a cura di Giampiero Carocci (Roma: Libreria dello Stato, 2007)

Documenti (I) Diplomatici Italiani, Terza serie: 1896-1907, Vol. IX (29 marzo 1905 – 28 maggio 1906), a cura di Francesco Lefebvre D'Ovidio, Pietro Pastorelli (Roma: Libreria dello Stato, 2012)

Documenti (I) Diplomatici Italiani, Terza serie: 1896-1907, Vol. X (28 maggio 1906 – 31 dicembre 1907), a cura di Pietro Pastorelli, Francesco Lefebvre D'Ovidio (Roma: Libreria dello Stato, 2014)

Documenti (I) Diplomatici Italiani, Quarta serie: 1908-1914, Vol. VII-VIII (30 marzo 1911 – 18 ottobre 1912), a cura di Edoardo Del Vecchio (Roma: Libreria dello Stato, 2004)

Literaturë:

ADRIATICO. *Adriatico, Studio geografico, storico e politico*. Milano: Treves, 1915.

- BALDACCI, Antonio. *Studi speciali albanesi*. Vol. 1. Roma: Anonima Romana Editoriale, 1932; Vol. 2. Roma: Anonima Romana Editoriale, 1933.
- BARBARICH, Eugenio. *Albania*. Roma: Editore Enrico Voghera, 1905.
- BECHERELLI, Alberto & Andrea Carteny. *L'Albania indipendente e le relazioni italo-albanesi (1912-2012): Atti del Convegno in occasione del centenario dell'indipendenza albanese (Roma, 22 novembre 2012)*. Roma: Nuova Cultura, 2013.
- BIAGINI, Antonio. *L'Italia e le guerre balcaniche*. Roma: Ufficio storico S.M.E., 1990.
- BONDIOLI, Pio. *Albania quinta sponda d'Italia*. Milano: C.E.T.I.M, 1939.
- BORGOGNI, Massimo. *Tra continuità e incertezza: Italia e Albania (1914-1939). La strategia politico-militare dell'Italia in Albania fino all'Operazione «Oltre Mare Tirana»*. Milano: Franco Angeli, 2007.
- CAILLER, Claude Alexandre. *La politique balkanique de l'Italie entre 1875 et 1914*. La Tour-de-Peilz: Imprimerie Stalder-Vodoz, 1951.
- Crispi per un antico parlamentare col suo diario della spedizione dei mille*. Roma: Edoardo Perino Editore-Tipografo, 1890.
- FERRARIO, C. A. *Vicende e problemi della penisola balcanica 1815-1937*. Milano: Istituto per gli studi di politica internazionale, 1937.
- GIANNINI, Amedeo. *La formazione dell'Albania*. Roma: Anonima Romana Editoriale, 1929.
- GIANNINI, Amedeo. *L'Albania dall'indipendenza all'unione con l'Italia, 1913-1939*. Milano: Istituto per gli studi di politica nazionale, 1939.
- GUIDA, Francesco. "Ricciotti Garibaldi e il movimento nazionale albanese." *Archivio storico italiano*, no. 507 (1981).
- INGLESE, Nicolo. *Crispi*. Milano: Dall'Oglio, 1961.
- LOISEAU, Charles. *L'équilibre adriatique (l'Italie et la question d'Orient)*. Paris: Perrin et Cie, 1901.
- MANDALARI, O. C. "Ricciotti Garibaldi per la indipendenza dell'Albania: Dal Comitato pro Albania del 1904 alla spedizione garibaldina del 1911." *Camicia Rossa*, no. 2 (febbraio 1933).
- MANARESI, Alfonso. *Storia Contemporanea*. Milano: Casa Editrice Trevisini, 1931.
- MARENIN, N. *Shqipëria dhe shqiptarët*. Tiranë: ENEAS, 2012.
- MARCHIANO, Michele. *Albania e l'opera di Girolamo De Rada*. Trani: V. Vecchi, 1902.
- MASERATI, Ennio. *Momenti della questione adriatica (1896-1914): Albania e Montenegro tra Austria ed Italia*. Udine: Del Bianco, 1981.
- MONTEGAZZA, Vico. *L'Albania*. Milano: Bontempelli & Invernizzi, 1912.

- NANI, U. "I rapporti con l'Albania da Francesco Crispi ad oggi." *La Terra*, no. 6 (prill 1939).
- NERI, Rolando. *Sonnino, Guicciardini e la politica estera italiana 1899-1906*. Roma: Edizioni ETS, 2005.
- PASTORELLI, Pietro. "Albania e Tripoli nella politica estera italiana durante la crisi d'Oriente del 1897." *Rivista di Studi Politici Internazionali* 28, no. 3 (korrik-shtator 1961): 351-380.
- PRENUSHI, Mikel. "Vështrim historik mbi zhvillimin e arsimit në Shkodrën e shek. XIX." *Studime historike*, nr. 3 (1974): 123-145.
- REGGIO, Isidoro. *Storia della Grande Guerra*. Milano: Istituto Editoriale Italiano, 1916-1919.
- ROVERE, Alberto. *Italia ed Austria nella questione d'Oriente*. Palermo: 1887.
- SANMINIATELLI, Donato. *I rapporti tra l'Italia e l'Albania*. Firenze: Ufficio della Rassegna nazionale, 1901.
- SCHIRO, Giuseppe. *Gli albanesi e la questione balcanica*. Napoli: Ferd. Bideri, 1904.
- SINANI, Beqir. "Politika arsimore e Italisë imperialiste ndaj Shqipërisë 1888-1920." *Studime historike*, nr. 4 (1970): 89-112.
- SKËNDI, Stavro. *Zgjimi kombëtar shqiptar 1878-1912*. Tiranë: Phoenix & Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, 2000.
- TAMARO, Attilio. *L'Adriatico golfo d'Italia: L'italianità di Trieste*. Milano: Fratelli Treves, 1915.
- TITTONI, Tommaso. *Italy's Foreign and Colonial Policy*. London: Smith, Elder & Co., 1 janar 1914.
- TORRE, Augusto. *La politica estera dell'Italia dal 1870 al 1896: Lezioni tenute nell'Università di Bologna durante l'anno accademico 1958-59*. Bologna: Casa Editrice prof. Riccardo Patron, 1959.
- VALORI, Francesco. *Dizionario delle Battaglie*. Varese-Milano: Casa Editrice Ceschina, 1968.
- VIRGILIJ, Giovanni Amadori. *La questione rumeliota (Macedonia, Vecchia Serbia, Albania, Epiro) e la politica italiana*. Vol. primo. Bitonto: N. Garofalo, 1908.
- WERNICKE, Annelise. *Teodor Ipen dhe Shqipëria në fokusin e Perandorisë Austrohungareze*. Tiranë: Plejad, 2012.

ASSOC. PROF. DR. HASAN BELLO

Institute of History / Academy of Sciences of Albania

hasanbello1@gmail.com

**ITALY'S EXPANSIONIST POLICY TOWARDS THE ALBANIAN TERRITORIES
FROM THE END OF THE XIX CENTURY UNTIL THE BEGINNING OF THE XX
CENTURY***S u m m a r y*

Italy's expansionist policy toward Albanian territories unfolded as part of a strategy to dominate the Adriatic coast and the Balkans. It began during Prime Minister Crispi's tenure and was consolidated by subsequent governments. The focus of Italian expansionism was not limited to Albanian Catholics but also included Albanian Muslims. All available means were employed to instrumentalize them, ranging from educational institutions and clergy to the press, postal offices, maritime transport, hospitals, and various commercial firms. This brought Italian policy into confrontation with a major factor in the Albanian territories: the Austro-Hungarian Empire, which regarded Albania as its own sphere of influence.

Keywords: Albania, Italy, Austro-Hungary, italian expansionist policy, education.